

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Tonka Berishaj, kryetare, Have Haliti dhe Fillim Skoro anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.E., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit H.E., av. M.A., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Gjilan, PKR.nr.115/18, të datës 30.05.2018, në seancën e mbajtur konformë dispozitës së nenit 390 të KPPK-së, me datë 24.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet, si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit H.E., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-DKR, PKR.nr.115/18, i datës 30.05.2018, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore –DKR në Gjilan, PKR.nr.115/18, të datës 30.05.2018, i akuzuari H.E., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, është dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, i cili dënim do të ekzekutohet pas 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në rast se i akuzuari refuzon që ta paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj ,atëherë dënimi me gjobë në pajtim me të akuzuarin do t'i zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohet me 20 €, të dënimit me gjobë, nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20(njëzet) € të dënimit me gjobë caktohet nga 1(një) burgim.

Të akuzuarit në bazë 62,69 dhe 374 par.3 të KPRK-së, i është shqiptuar dënim plotësues, i është konfiskuar pushka e gjuetisë “128-369” me nr. serik 3802/12.

I akuzuari është obliguar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) €, në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.E., av. M.A., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave të KPRK-së, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj, ose të njëjtin ta prish dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit, me parashtesën PPA/I.nr.365/18, të datës 06.09.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit, av. M.A., dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit konform nenit 390 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit, për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, meqenëse të akuzuarit nuk i është shqiptuar dënim me burgim.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit av. M.A. dhe pas vlerësimit edhe të shkresave tjera në lëndë gjeti se:

Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit është e pa bazuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit, në ankesë pretendon se gjykata e shkallës nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, se i akuzuari përveç se një herë ishte fotografuar me armën të njëjtën asnjëherë nuk e ka pasur në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar, sepse me të dispononte tani i dënuari për armën e njëjte M.B., i cili është dënuar me gjobë në shumë prej 200 €, në shtëpinë e të cilit është konfiskuar edhe arma, se mos të kishte qenë arma e tij, tashmë i dënuari M. kurrë nuk do të kishte pranuar që arma të vendoset në shtëpinë e tij, se deklaratën e tij në polici i akuzuari H. e ka dhënë vetëm për ta ndihmuar dëshmitarin eventualisht nga përgjegjësia penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, nuk qëndrojnë, se nga shkresat e lëndës, respektivisht nga provat e administruara, si dhe nga mbrojtja e të akuzuarit del se i akuzuari nga data e pa vërtetuar e deri me 13.12.2017 në Fsh. Pozhoran pa leje valide për armët ka mbajtur në posedim pushkën e gjuetisë me nr. 128-369 modeli amsport me nr. 2802/1, e cila ishte konfiskuar nga policia të M. B. të cilën armë të njëjtën ditë i akuzuari e kishte dërguar të punëtorin e M. e pastja me polici kishte shkuar për të marrë.

Këtë gjendje faktike gjykata e shkallës se parë, e ka vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit M.B., i cili në shyrtime gjyqësor kishte deklaruar se armën të cilën e kishte marrë policia ditën kritike në punëtorin e tij, e kishte lënë i akuzuari H. të njëjtën ditë dhe nuk e kishte ditur se nuk kishte leje për armën dhe të njëjtën ditë pas 2-3 orëve kishte shkuar policia në punëtorin e tij sëbashku me të akuzuarin H.E. dhe e kishim marrë armën, të cilin fakt nuk e ka mohur as i akuzuari H. në shyrtime gjyqësor dhe në procedurën paraprake, se armën e ka pasur në posedim të cilën e kishte larguar nga shtëpia duke e dërguar në punëtorin e M.B. në Kllokot për të cilën nuk kishte poseduar leje, se e kishte blerë nga një person për 200 euro dhe se më të njëjtën armë ishte fotografuar në telefon, se të njëjtën ditë që e kishte lënë armën të M. kishte shkuar me polici me e marrë, kurse pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, se i akuzuari përveç se është fotografuar me armën nuk e ka poseduar, nuk qëndrojnë, ashtu që, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësit

të akuzuarit, se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendje faktike, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Gjykata e Apelit lidhur me shkeljen e ligjit penal, vlerëson se me provat e administruar është vërtetuar, se i akuzuari ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK-së, se i akuzuari nuk ka poseduar leje për armët e gjuetisë, dhe gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka shpallur fajtor për këtë veprë penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë nuk e përmend bazën ankimore sa i përket vendimit mbi dënimin, por kjo gjykatë e vlerësoj edhe mbi këtë bazë, duke u bazuar në bazat tjera ankimore.

Gjykata e Apelit, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat kanë ndikuar në lartësinë e dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë parasysh sjelljet të mira gjatë shqyrtimit gjyqësor, më parë nuk ka qenë i dënuar, moshën e re, kurse rrethana rënduese nuk ka përmendur, kjo gjykatë, vlerësimin e rrethanave lehtësuese që i ka pasur parasysh gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit, i aprovon në tërësi dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se dhe në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK.

Nga çka u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.387/18, të dt.24.09.2018

Procesmbajtësja,

Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit

1.Have Haliti

2. Fillim Skoro

Kryetari i kolegjit

Tonka Berishaj